



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafëve 1, 2 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17, dhjetor 2012), nenit 21 të Rregullores QRK, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe të nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1 shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2017, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronares Shpresa (Sejdi) Etemi.
- II. Prona e paluajtshme e Komunës që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: Pjesën e parcelës kadastrale nr. 1413-0, ZK Matëçan, e evidentuar në Certifikatën e pronësisë P-71914050-01413-0, pjesën e parcelës kadastrale nr. 792-0, ZK Matëçan, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-00793-37, dhe pjesën e parcelës kadastrale nr. 793-50, ZK Matëçan, e evidentuar në Certifikatën e pronës P-71914050-00793-50, me pronën e paluajtshme në pronësi të znj. Shpresa (Sejdi) Etemi, pjesë e parcelës kadastrale nr. 827-20, ZK Matëçan, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914050-0827-20.
- III. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private.
- IV. Këmbimi i pronave të paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues urban. Kjo i shërben shfrytëzimit për qëllime të interesit publik të Komunës dhe kapitali për financimin e këmbimit është i siguar.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.

- VI. Prona e paluajtshme komunale që do të këmbehet, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: shkresat e lëndës (pjesa e grafikës dhe certifikata e pronësisë).
- IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. 464/01-0245939/17, më 02.10.2017



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dpl.